



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë, më 13.11.2018

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME VENDIN PRITËS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ZYRËS RAJONALE PËR BASHKËPUNIM RINOR”

- HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 13 nëntor 2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor”. Komisioni caktoi si relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Elena Xhina. Komisioni e shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për të paraqitur projektligjin, në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Europës dhe Punëve të Jashtme.

- BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji, nismë e Këshillit të Ministrave, është bazuar në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, si dhe në nenin 18 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje ndihmon në zbatimin e “Marrëveshjes ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor”, e cila ndjek objektivat e përcaktuara si pjesë e “Procesit të Berlinit” dhe “Deklaratës së përbashkët për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor në Ballkanin Perëndimor”.

Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor është një mekanizëm institucional rajonal me mandat dhe kapacitet për të krijuar kushtet dhe për të mbështetur aktivitetet që nxisin vlerat demokratike, pjesëmarrjen, qytetarinë aktive dhe të mësuarit ndërkulturor, përmes krijimit të mundësive të rinjve që të takohen, të njihen, të krijojnë shoqëri dhe të angazhohen në dialog rajonal në çështje që do t’i mbështesin ata për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për të gjithë.

Krijimi i Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor edhe në Tiranë do të shërbejë si instrument për përshpejtimin e bashkëpunimit rajonal jo vetëm rinor, por edhe më gjerë.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

-Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

-Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi me votat e shumicës së anëtarëve dhe vendosi t’ia kalojë për miratim seancës plenare.

RELATORE

Elena XHINA

KRYETARI

Ulsi MANJA